



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA ELBASAN
DREJTORIA E PROKURIMEVE PUBLIKE

Nr. _____ prot.

Elbasan, më _____.____.2024

LËNDA: Dërgim njoftimi për botim në Buletinin e Prokurimit Publik.

AGJENCISË së PROKURIMIT PUBLIK

TIRANË

FORMULARI I NJOFTIMIT TË OPERATORËVE EKONOMIKË TË
SUKESSHËM NË MARRËVESHJEN KUADËR
(NË PËRFUNDIM TË AFATEVE TË ANKIMIT)

Nga: **Bashkia Elbasan** adresa: rruga “Qemal Stafa”, Elbasan

Drejtuar: **“Blerina Sadiku” p.f.** me adresë: Berat Perondi MAGJATE Godinë 1 katëshe në Magjatë pranë ish-uzinës së aviacionit.

Procedura e prokurimit: Proçedurë e hapur e thjeshtuar - Marreveshje Kuader.

Përshkrim i shkurtër i kontratës: “Blerje veshje për policinë Bashkiake” - Marrëveshje Kuadër me fond limit **3,102,117** (tremilion e njëqind e dymijë e njëqind e shtatëmbëdhjetë) **lekë (pa tvsh)**. Shumatorja e çmimeve për njësi është: **101,443** (njqind e njemije e katerqind e dyzet e tre) **leke pa t.v.sh.**, vene ne dispozicion nga Buxheti i Bashkise Elbasan per vitin 2024 dhe 2025. Ky fond perben vleren e pritshme te kontratave qe mund te lidhen gjate marreveshjes kuader.

Numri i referencës së procedurës/lotit: REF-95887-02-20-2024

Publikime të mëparshme (nëse aplikohet): Buletini i Njoftimeve Publike [Data] [Numri]

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit:

oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar ne kosto

oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në çmim

Me anë të kësaj bëjmë me dije se, në këtë procedurë kanë marrë pjesë operatorët ekonomikë të mëposhtëm me vlerat përkatëse si më poshtë:

1. “BLERINA SADIKU” p.f. me Nipt: K 97730102 T

Shumatorja e çmimeve për njësi të ofruar është **66'940** (gjashtedhjetë e gjashtëmijë e nenteqind e dyzet) **lekë** (pa tvsh).

2. “MALBERTEX” sh.p.k me Nipt: K 71821009 N

Shumatorja e çmimeve për njësi të ofruar është **65'630** (gjashtedhjetë e pesëmijë e gjashtëqind e tridhjetë) **lekë** (pa tvsh).

Operatorët ekonomikë të s'kualifikuar janë:

Malbertex

1. Çertifikatat e paraqitura për artikujt xhup dhe xhiboks nuk përmbajnë standartin SSH/EN 342:2017 duke mos përmbushur kërkesën e parashikuar në pikën 2.3.4 të kriterëve të veçanta, kapaciteti teknik dhe profesional, ku kërkohet:

2.3.4 Operatori ekonomik për artikujt e kërkuar duhet të paraqesë çertifikatat e produktit si mëposhtë:

- **Xhup - SSH/EN 342:2017; SSH/EN ISO 20471:2013+A1:2016 klasi 2. SSH/EN 343:2019 klasi 3, SSH/ EN ISO 13688/2013e vlefshme ose ekuivalente**
- **Xhiboks - SSH/EN 342:2017; SSH/EN ISO 20471:2013+A1:2016 klasi 2. SSH/EN 343:2019 klasi 3, SSH/ EN ISO 13688/2013e vlefshme ose ekuivalente**
- **Jelek fosforeshent - SSH/EN ISO 20471:2013+A1:2016 klasi 2. SSH/EN 343:2019 klasi 3, SSH/ EN ISO 13688/2013 e vlefshme ose ekuivalente**
- **Pelerinë shiu - SSH/EN 343:2019 klasi 3 e vlefshme ose ekuivalente**

2. Pas verifikimit të dokumentacionit të paraqitur në SPE, për artikujt xhup, xhiboks, jelek fosforeshent dhe pelerinë shiu, për të cilat janë kërkuar edhe çertifikatat e produktit sipas pikës 2.3.4, keni deklaruar si prodhues kompaninë "Industrial Wear SRL A Socio Unico". Në mostrat e paraqitura për këto artikuj etiketa nuk e ka të shënuar emrin e prodhuesit, duke mos i vertetuar Ak prodhimin e këtyre artikujve nga prodhuesi i deklaruar.

Gjithashtu në etiketën e artikujve xhup dhe xhiboks ndër të tjera, është i pasqyruar edhe standarti EN 342:2007. Ky standart pas verifikimeve nuk ekziston (standarti aktual i vlefshëm është EN 342:2017, i cili ka zëvendësuar standartin EN 342:2004, gje që rezulton edhe nga Katalogu i Standarteve Shqiptare 2021). Për më tepër që

çertifikatat e produktit te kompanisë "Industrial Wear SRL A Socio Unico" nuk e permbajne kete standart. duke mos përmbushur kërkesat e parashikuara në pikën 2.3.4 dhe 2.3.5 të kriterëve të veçanta, kapaciteti teknik dhe profesional.

Operatori ekonomik s'kualifikohet për arsyet e mësipërme.

Në LPP nr. 162, datë 23.12.2020 "Për Prokurimin Publik", neni 92, pika 3, parashikohet se: 3. Autoriteti ose enti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, pa rënë ndesh me përcaktimet e nenit 38 të këtij ligji.

Në VKM nr.285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik", i ndryshuar, neni 82 parashikohet se: Komisioni i vlerësimit të ofertave verifikon dhe vlerëson ofertat e dorëzuara, duke kualifikuar vetëm ato oferta, që përmbushin kërkesat për kualifikim, të përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe janë të përgjegjshme/vlefshme.

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë operatorin ekonomik **"Blerina Sadiku" p.f.**, me adresë: Berat Perondi MAGJATE Godinë 1 katëshe në Magjatë pranë ish-uzinës së aviacionit, se oferta e paraqitur me shumatoren e çmimeve për njësi prej **66'940** (gjashtedhjetë e gjashtëmijë e nentëqind e dyzet) **lekë** (pa tvsh), është identifikuar si oferta e suksesshme.

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqisni pranë **Bashkisë Elbasan (Drejtoria e Prokurimeve)** brenda 5 (pese) ditëve nga data e marrjes/publikimit të këtij njoftimi për të lidhur marrëveshjen kuader.

Ankesa pas Njoftimit te Fituesit (Paraparak)

PO JO

Nëse Po (vendimi përfundimtar për trajtimin e ankesës/ave nr. datë) _____

Ankesa pas Njoftimit të Anullimit të procedurës:

PO JO

Nëse Po (vendimi përfundimtar për trajtimin e ankesës/ave nr. datë) _____

**TITULLARI I AUTORITETIT KONTRAKTOR
PERSONI I AUTORIZUAR PREJ TIJ
ZV.KRYETARI
Asim Sula**